

Date: 19.03.2021

SHËNIME MBI PASOYRAT FINANCIARE**1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM****a. Organizimi**

Shoqëria “Gjoka 87” shpk është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datë 16.04.2018 në Tiranë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 634 datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncension /partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale” të ndryshuar, dhe kontratës koncensionare/ppp “Për përmirësimin, ndërtimin, operimin dhe mirmbajtjen e rrugës së Arbrit” të lidhur në Tiranë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr 553 rep, nr. 247 kol datë 16.03.2018 dhe miratuar me VKM nr 180. Datë 23.03.2018 e botuar në Fletoren zyrtare nr 50 datë 11.04.2018.

Shoqëria “Gjoka 87” shpk është rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numrin unik të identifikimit të subjektit NUIS: **L81618040T** dhe seli në adresën rr. Dora D'Istria, Hyrja nr 6, Nr Pasurie 7/367+1-N5, zona kadastrale 8270, Tiranë.

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do të jetë deri në datën 16.04.2031, 13 vjet nga dita e rregjistrimit.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

b. Objekti

Objekti I aktivitetit të shoqërisë “Gjoka 87” shpk është për “Zbatimin e kontratës koncensionare/ppp “Përmirësimi, ndërtimi, operimi, dhe mirëmbajtje e Rrugës së Arbrit”, sipas kontratës së lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.553 rep, Nr.247 kol, datë 16.03.2018, në Tiranë Shqipëri dhe të miratuar me VKM Nr.180, datë 28.03.2018 dhe e botuar në Fletoren Zyrtare Nr.50, date 11.04.2018, e cila do t'i kalohet shoqërisë Gjoka 87 sh.p.k në datën e themelimit të saj. Në këtë kuadër, shoqëria Gjoka 87 sh.p.k ka të drejtë të kryejë të gjitha dhe cdo aktivitet të nevojshëm për realizimin e objektit të saj”.

c. Kapitali

Themeluesi I shoqërisë “Gjoka 87” shpk është shoqëria “Gjoka Konstruksion” sha themeluar në 01.04.1994 dhe e rregjistruar në QKB ne date 24.03.1999 me NUIS: J91815014U, me seli në adresën rr. Dora D'Istria, Hyrja 1&2, Tiranë, me administrator të shoqërisë z. Rrok Gjoka.

Kapitali I shoqërisë “Gjoka 87” shpk I rregjistruar në QKB është **1,809,272,309 lek**.

d. Administrimi

Shoqëria “Gjoka 87” shpk drejtohet nga Administratori z. Erind Gjoka.

2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL TE RËNDËSISHME**I. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare**

Baza e përgatitjes



Pasqyrat financiare të shoqërisë “Gjoka 87” shpk për vitin 2020 janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe interpretimet e ligjit nr 9228 dt 29 prill 2004” Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK). Pasqyrat financiare në fund të vitit 2020 janë paraqitur sipas formatit të paraqitur në Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në fuqi (SNK).

Baza e matjes

Sipas parimeve të kontabilitetit pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël të cilave u përkasin.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse.

Përdorimi i gjykimeve dhe hamëndësimeve

Paraqitja e Pasqyrave Financiare konform SNRF-ve, kërkon që manaxhimi të bëjë vlerësime, gjykime e supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerën e raportuar të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave e shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur ndodh rishikimi dhe në çdo periudhë të ardhme që preket.

Monedha e paraqitjes

Pasqyrat financiare paraqiten në monedhën vendase Lek Shqiptar.

II. Politikat kontabël të përdorura

2.1 Instrumentat financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumenta financiare jo-derivative që përfshijnë llogari të arkëtueshme nga klientët, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe llogari të tjera për t'u paguar apo për t'u arkëtuar me karakter tregëtar.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhet me to, përveç rasteve të vecanta.

a. Mjete Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj përfshijnë tepricat e arkës, bankës, depozitat në banka investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe afat maturimi më pak se 1 vit, të cilat nuk janë subjekt i riskut të ndryshimit të vlerës së drejtë dhe përdoren nga shoqëria në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

b. Kërkesa për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar afatshkurtra janë paraqitur në bilanc me kosto të amortizuar .

c. Detyrime të pagueshme

Detyrimet për t'u paguar dhe të tjera detyrime paraqiten me vlerën e drejtë të tyre dhe më pas maten me vlerën e tyre të amortizueshme.

d. Hua bankare dhe të tjera

Në vazhdim të njohjes fillestare, huatë bankare dhe të tjera paraqiten me kosto të amorizueshme duke njohur cdo diference midis koston dhe vlerës së rikuperueshme në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes në bazë të interesit efektiv. Detyrimet financiare klasifikohen si afatshkurtra kur ato kerkohen per tu shlyer brenda dymbedhjete muajve pas periudhes se raportimit.

2.2 Inventarët

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre vlerësohen me koston më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

2.3 Aktivët afatgjata materiale

Në bilanc aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Aktivët afatgjata materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit është mbi bazën e metodës së vlerës së mbetur. Toka dhe ndërtime në proces nuk amortizohen si dhe parapagimet e furnitorëve nuk amortizohen.

2.4 Aktivët afatgjata jo – materiale

Në bilanc Aktive afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

2.5 Kuotat e kapitalit

Kuotat e thjeshta njihen si kapital. Kuotat njihen me vlerën e tyre nominale.

2.6 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera kontabile e aktiveve jofinanciare të shoqërisë rishikohet në cdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim.

2.7 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ekzistojnë tregues sipas të cilëve ngjarje të caktuara kanë një ndikim negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë prej një aktivi.

Humbja dhe zhvlerësimi në rastin e një aktivi financiar të vlerësuar me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël neto dhe vlerës aktuale të flukseve të pritshme të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

2.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të shoqërisë.

2.9 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara.

2.10 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare janë të ardhurat nga interesi i depozitave bankare, fitimet nga këmbimet valutore etj.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet për interesat nga huatë, humbjet nga kurset e këmbimit valutor. Gjithë kostot e huamarrjeve njihen në humbje/fitime mbi bazën e përdorimit të metodës së interesit efektiv.

2.12 Tatim fitimi aktual dhe i shtyrë

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi të ardhurat paraqitet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur ai lidhet me zërat e kapitalit dhe në këtë rast paraqitet direkt në kapital.

2.13 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja rregjistrohen në monedhën funksionale dhe konvertohen në monedhën e raportuese duke përdorur kurset e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Fitim humbjet që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundvitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ZBËRTHIME TË ZËRAVE TË BILANCIT

3. AKTIVET AFATSHKURTRA

Të drejtat e arkëtueshme janë faturat e palikuiduara për situacionet e faturuara dhe të palikuiduara.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Llogari te arketueshme tregtare dhe llogari te tjera te arketueshme		
Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë	14,399,014,915	10,533,288,060
Totali	<u>14,399,014,915</u>	<u>10,533,288,060</u>

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Tatim fitimi i parapaguar		
Tatim fitimi	252,371	196,103
Totali	252,371	196,103

4. MJETET MONETARE

Gjendja e llogarisë së likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohet me nxjerrjet e llogarive bankare.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to		
Banka	19,441,745	334,767
Arka	10,917	23,417
Totali	19,452,662	358,184

5. KAPITALI DHE REZERVAT

Gjendja e llogarisë së kapitalit të nënshkruar dhe të rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe rezervave është si mëposhtë:

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nënshkruar dhe primi i kapitalit	1,809,272,309	1,809,272,309
Rezerva të tjera	1,775,923	1,440,726
Rezerva ligjore	93,470	75,828
Totali	1,811,141,702	1,810,788,863

6. DETYRIMET AFATGJATA

Huaja afatgjatë përbëhet nga shuma e huasë së disbursuar nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime afat gjata		
Hua afat gjatë bankë	3,454,284,722	2,940,000,000
Totali	3,454,284,722	2,940,000,000

7. DETYRIMET AFATSHKURTËR

Llogaritë e furnitorëve dhe të tjera llogari të pagueshme janë vlerësuar me vlerën e drejtë.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime afatshkurtra		
Llogari te pagueshme tregtare dhe llogari te tjera te pagueshme	9,107,906,643	5,778,123,917
Totali	<u>9,107,906,643</u>	<u>5,778,123,917</u>

Huamarrje afatshkurter jane klasifikuar vlere e huase bankare qe duhet te paguhet brenda dymbedhjete muajve te vitit pasardhes sipas SNK 1, paragrafi 72.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime afatshkurtra		
Huamarrje afatshkurter	38,250,000	0
Totali	<u>38,250,000</u>	<u>0</u>

8. DETYRIMET NDAJ TATIMOREVE DHE PUNONJËSVE

Detyrimet ndaj tatimeve përfaqësojnë shumën e detyrimeve për sigurime, tatim fitimi, tatim në burim. Detyrimet ndaj punonjësve janë pagat për t'u paguar që i përkasin muajit dhjetor'20.

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Detyrime per tatimin aktual		
Të pagueshme ndaj punonjësve	120,956	120,956
Detyrime për sigurime shoqërore	26,672	33,195
Tatim mbi të ardhurat personale	15,600	15,600
Tatim mbi fitimin	-	-
TVSH	6,894,559	3,920,111
Tatimi në burim	4,500	4,500
Totali	<u>7,062,287</u>	<u>4,094,362</u>

ZBËRTHIME TË ZËRAVE TË PASOYRES SË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
Shitje sipas situacionit të punimeve	5,845,990,606	5,617,734,172
Totali	<u>5,845,990,606</u>	<u>5,617,734,172</u>

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Shpenzime personeli		
Shpenzime për pagat	1,812,988	1,800,000
Shpenzime sigurime shoqërore, shëndetsore	239,180	237,012
Totali	<u>2,052,168</u>	<u>2,037,012</u>

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Te ardhura/(shpenzime) financiare, neto		
Shpenzime për interesa	220,305,650	167,235,833
Totali	<u>220,305,650</u>	<u>167,235,833</u>

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Shpenzime te tjera		
Punime me nënkontraktorë	5,618,948,521	5,433,408,060
Shpenzime qeraje	360,000	360,000
Shpenzime konsulence, kolaudime punimesh etj	196,669	1,630,000
Shpenzime për shërbimet bankare	3,835,600	11,912,050
Gjoha dhe penalitete	111,944	52,471
Dieta dhe udhetime	0	608,782
Taksa, tarifa tatime të tjera	72,400	65,600
Totali	<u>5,623,525,134</u>	<u>5,448,036,963</u>

15. LLOGARITJA E TATIMIT MBI FITIMIN

	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Të ardhurat	5,845,990,606	5,617,734,172
Shpenzimet	5,845,882,952	5,617,309,808
Fitimi Bruto	107,654	424,364
Shpenzime te panjohura	111,944	52,471
Fitmi para tatimit	219,598	476,835
% e Tatim Fitimit	15%	15%
Tatim fitimi	32,940	71,525
FITIMI NETO	74,714	352,839

NGJARJET PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje tjetër pas datës së raportimit që kërkon rregullime apo informacione shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare të shoqërisë.

“GJOKA 87” SHPK

Administratori

Erind GJOKA

Erind Gjoka


GJOKA
L 81618040 T